



Analizë e Buxhetit të Shtetit për Vitin 2026

NJË ANALIZË MBI SITUATËN AKTUALE, PRIORITETET, TRENDET
DHE RREZIQET STRUKTURE
INSTITUTI KONSERVATOR SHQIPTAR

Përmbajtja

Situata aktuale.....	2
Investitorët e huaj dhe perceptimi i tyre mbi klimën e biznesit	3
Iluzioni i Rritjes dhe Realiteti i Rënies	4
Kostot Familjare	5
Tregu i Punës dhe Emigracioni	5
Paraja e Pista dhe Ekonomia Informale.....	5
Borxhi Publik dhe Perceptimi Shoqëror	6
Klima e Biznesit dhe Varfëria Strukturore	7
Siguria në vend	7
Shëndetësia	8
Arsimi	10
Kërkimi shkencor: motor i fikur	10
Projektbuxheti i prezantuar nga Qeveria	11
Korniza makro-fiskale: Rritje në Letër, Brishtësi në Thelb	11
Struktura e Buxhetit: Një Shtet që Rritet më Shpejt se Ekonomia	11
Skenari i mundshëm i rritjes më të ulët (2026).....	13
Shpenzimet Korrente: Konsum Publik në Vend të Prodhimit	14
Investimet Publike: Shifra të Mëdha, Produktivitet i Vogël.....	14
PPP-të dhe Koncesionet: Borxh i Padukshëm dhe Investime që Nuk Krijojnë Ofertë	15
Arsimi dhe Shëndetësia: Rënia e Investimit në Kapitalin Njerëzor	15
Fonde Speciale dhe Skemat e Varura nga Buxheti	16
Red Flags: Sinjalet e Rrezikut Fiskal dhe Struktural	17
Përfundim: Një Mundësi e Humbur për Reformë të Vërtetë.....	17

Situata aktuale

Shqipëria hyn në vitin fiskal e kalendarik 2026 me një ekonomi që mbart të gjitha simptomat e një modeli të dështuar:

- **prodhimi po tkurret prej vitesh,**
- **eksportet po bien,**
- **bujqësia dhe industria janë në recesion të vazhdueshëm, dhe**
- **popullsia e aftë për punë po largohet me ritme alarmante. (EUROSTAT: 1,1 milionë të larguar në 10 vite).**

Vendi rritet në letër, por varfërohet ndjeshëm përditë, në realitet. Në vend të rritjes së ofertës, kapitalit prodhues dhe investimeve me vlerë të shtuar, shteti vazhdon të mbështetet tek ndërtimi (ku burime të shumta të huaja dhe vendase e thonë se kanalizohen e pastrohen paratë e pista), turizmi dhe shpenzimet qeveritare. Por dhe turizmi këtë vit u rrit me një normë të ngadalësuar krahasim me vitin e kaluar, ndërkohë në ndërtim ka shenja që tregojnë se po ngadalësohet dhe ky sektor, si p.sh. prodhimi i betonit në rënie.

Këtë tablo e vërtetojnë edhe analizat e pavarura: rritja e të ardhurave qeveritare vjen kryesisht nga konsumi (TVSH komponenti kryesor, në rritje për shkak të rritjes së çmimeve e jo sasisë së konsumit), jo nga prodhimi; ndërsa inflacioni i çmimeve bazë (ushqim/energji) po gëlltit përfitimet nominale të pagave dhe pensione. Në praktikë, kemi një stabilitet fiktiv, në letër, jo një zhvillim real.

Në pamje të parë, raportet makroekonomike duken të qëndrueshme: inflacioni total është ulur në 2.8%, deficitin buxhetor mbahet nën 2.3% të PBB-së, dhe borxhi publik në 53.6%.

Në thelb, rritja ekonomike shqiptare është **rritje nominale**, e ndërtuar mbi konsum (të ngadalësuar, dhe që mbahet nga konsumi i qeverisë) dhe ndërtim, jo mbi prodhim, eksport apo inovacion. Sipas të dhënave të INSTAT, mbi **60% e rritjes së PBB-së** në vitin 2025 ka ardhur nga **konsumi familjar (i cili harxhon kryesisht për ushqim dhe elemente bazë)** dhe **administrata publike**, ndërsa kontributi i sektorit prodhues ka qenë negativ: **bujqësia -2.5%** dhe **industria -1.8%** në tremujorin e dytë 2025 (INSTAT). Viti 2020 nisi me një rritje të fortë prej 5.2% në tremujorin e parë, e ndjekur nga +3.6% në tremujorin e dytë, por rënia me bujqësinë nisi në 6-mujorin e dytë të 2020 dhe nuk ndaloi më. Nga 2021, kriza u thellua. Tremujorët e parë dhe të dytë panë rënie me -1.6% dhe -3.8%, për të vijuar me -1.1%, duke çuar prodhimin vjetor të këtij viti me rënie -1.6%. Viti 2022 e thelloi më tej rënien me -4.8%. E njëjta situatë me tkurrje të prodhimit vijoi në 2023 dhe 2024, përkatësisht me -1.3% dhe -2%.

Vetë Banka e Shqipërisë, që duhet të ishte institucioni që sinjalizon rreziqet, **e ka relativizuar krizën reale**, duke folur për “qëndrueshmëri monetare” në një kohë kur ekonomia reale është në stanjacion.

Në të vërtetë, **shfrytëzimi i kapaciteteve prodhuese** ka rënë ndjeshëm gjatë vitit 2025, ndërsa **treguesi i ndjesisë ekonomike** u ul me 1.3 pikë në shtator, duke sinjalizuar pritshmëri të dobëta për 2026. Këto të dhëna nuk janë thjesht shifra: janë tregues se bizneset po prodhojnë më pak dhe qytetarët po konsumojnë më pak, pavarësisht rritjes së pagës minimale, apo asaj mesatare.

Nga ana tjetër, sipërfaqja bujqësore e përdorur **është rreth 695 mijë hektarë tokë bujqësore**, nga të cilat **vetëm 50% janë të përdorura plotësisht**, për shkak të mungesës së mekanizimit dhe ujitjes. Probleme kryesore për fermerët janë

- fragmentarizimi i tokës: pjesa më e madhe e fermerëve kanë parcela të vogla, 1-1.5 ha, vetëm 10% e fermerëve kanë më shumë se 5 ha tokë, gjë që vështirëson konkurrencën me rajonin;
- mungesa e mekanizimit dhe teknologjisë: vetëm 30% e fermerëve përdorin mekanizim modern, gjë që çon në rendimente të ulëta; investimet këtu vazhdojnë mbeten të ulëta;
- probleme me sistemin e ujitjes: 60% e tokës bujqësore vuan nga mungesa e ujitjes dhe kullimit;
- mungesa e aksesit në treg dhe subvencione të ulëta (vetëm 53 milionë euro në këtë buxhet): 30-50 euro/hektar vs. 150-200 euro/ha në BE. Gjithashtu, të fundit në rajon për subvencione, duke ulur konkurueshmërinë e fermerëve tanë. Ka raste të raportuara për abuzime me skemat e subvencioneve, klientelizëm, raste diskriminimi etj;
- Mungesa e një skeme fiskale të duhur për të ndihmuar fermerët dhe incentivuar prodhimin. Qeveria vazhdon të mbajë në fuqi skemën e dëmshme për prodhimin vendas, skemën diskriminuese të TVSH-së. Në vend që ta anulonte plotësisht, ajo parashikon që nga janari 2026 të rimbursojë 10% të vlerës së faturave të shitjeve ndaj subjekteve të tatueshme me TVSH. Edhe pse kjo masë mund të ketë një efekt të pjesshëm pozitiv, zbatimi i saj praktik mbetet i vështirë, ashtu siç e ka treguar edhe përvoja e mëparshme (në vijim e sqaruar);
- Mungesa e politikave vizionare afatmesme e afatgjata për të kaluar nga prodhimi në përpunim dhe industri të lehtë;
- Ka një garanci sovraane nga Qeveria prej 3 miliardë lekë në mbështetje të sektorit të bujqësisë, por nuk ka asnjë të dhënë, raportim periodik, monitorim apo informacion mbi impaktin, përfituesit, vlerat e kredituara e garantuara deri sot;
- shpopullimi masiv, sidomos në zonat rurale;
- Bllokimi i fondeve të IPARD, të cilat ky buxhet nuk i zëvendëson.
- Siguria ushqimore, një problem i pa adresuar, i vazhdueshëm

Investitorët e huaj dhe perceptimi i tyre mbi klimën e biznesit

Sipas **Anketës së FIAA 2025 mbi klimën e biznesit**, perceptimi i investitorëve të huaj për Shqipërinë ka pësuar përkeqësim krahasuar me vitin 2024:

- **Vlerësimi i klimës së biznesit:** 45/100 pikë në 2025, nga 49/100 në 2024 (rënie me 4 pikë).

- **Pritshmëritë për klimën e biznesit:** 50/100 pikë në 2025, nga 52/100 në 2024 (rënie me 2 pikë).
- **Korrupsioni i përjetuar nga bizneset e huaja:** 57/100 pikë në 2025, +6 pikë krahasuar me 2024.
- **Transparenca në procedurat qeveritare:** perceptuar si problem më i rëndë se në 2024.
- **Sistemi gjyqësor dhe impakti mbi biznesin:** problem më i lartë se në 2024.
- **Zbatimi i ligjeve dhe rregulloreve:** problem më i lartë se në 2024.
- **Sistemi i taksave:** rritje e problematikave në pothuajse të gjithë indikatorët
- **Prokurimet publike dhe procedurat e licencimit/lejeve:** rritje e problematikave krahasuar me 2024.
- **Tregu i punës:** problematik për mungesën e forcave të kualifikuara dhe rritjen e pagave.

Ky perceptim i investitorëve të huaj tregon se **klima e biznesit jo vetëm që nuk po përmirësohet, por po përkeqësohet**, duke reflektuar rritjen e korrupsionit, mungesën e transparencës dhe dobësitë e sistemit gjyqësor e fiskal. Kjo përforcon tablonë e brishtësisë strukturore të ekonomisë shqiptare dhe dobëson besimin ndërkombëtar.

<https://fiaalbania.al/wp-content/uploads/2025/11/2025-FIAA-Business-Environment-Survey-Findings-1.pdf>

Iluzioni i Rritjes dhe Realiteti i Rënies

Rritja e raportuar prej 3.9% në 2025, e cila pritet të shkojë në 4% në 2026 sipas Ministrisë së Financave (edhe kjo një rritje e pamjaftueshme për një vend si Shqipëria), është në fakt një **rritje e bazuar në shpenzime publike dhe në ndërtim**. Sipas parashikimit të fundit të FMN-së **projeksioni i rritjes për vitin 2025 u ul në 3.4%, nga 3.8% në raportin e pranverës së vetë FMN-së**. Banka Botërore parashikon një rritje prej 3.1% për vitin 2026, ndërkohë parashikimi i Komisionit European është 3.5%, të dyja shumë larg 4% të parashikuar nga Qeveria.

Sipas INSTAT, **administrata publike, arsimi dhe shëndetësia kontribuuan me +1.65 pikë përqindje në PBB në tremujorin e dytë 2025 (me një rritje prej 17% nga e njëjta periudhë e vitit të kaluar)**, ndërsa **bujqësia dhe industria kontribuuan negativisht (-0.46 dhe -0.18 pp)**. Kjo do të thotë se **ekonomia po mbahet nga vetë shteti**, përmes pagave, bonuseve dhe shpenzimeve të tjera qeveritare, dhe jo nga iniciativa private apo prodhimi.

Nëse një vend rritet vetëm përmes shpenzimeve të shtetit, por jo përmes prodhimit dhe eksporteve, ai nuk po bëhet më i pasur, po bëhet më i varur. Shqipëria po përjeton pikërisht këtë: **një ekonomi që varet nga vetvetja**, ku shteti huazon për të paguar shtetin, apo për të paguar për punë publike, ndërkohë vazhdon rritet varësia nga paratë e pista. Nëse nuk rritet sektori privat, prodhues, çdo rritje pagash apo e ekonomisë është iluzore dhe e paqëndrueshme në afatmesëm.

Duhet pasur parasysh që sektori publik mbahet me taksat e individëve dhe të sipërmarrjeve, pra nga sektori privat. Sa më shumë zgjerohet sektori publik, aq më shumë zvogëlohet sektori privat, deri sa të mbarojnë paratë që mbajnë shtetin në këmbë.

Kostot Familjare

Sipas të dhënave të INSTAT-it për vitin 2025, **niveli i të ardhurave familjare nuk e ka kaluar ende prapun e diversifikimit të konsumit, duke shpenzuar rreth 39,6% të buxhetit për ushqim (më e larta në Europë).** Inflacioni për 9 mujorin e vitit 2025 është rreth 2.4%, ndërkohë çmimet e ushqimeve u rritën me 1.8% vjetore, me luhatjet më të dukshme në vajra, yndyrna, qumësht, djathë, vezë e mish. Energjia dhe shërbimet bazë shënuan rritje me 4.1%. Pra, sidomos në qarqet e varfra, ekonomia familjare është e përqendruar te mbijetesa, jo te zhvillimi apo kursimi.

Në raportimin e Monitor, sipas të dhënave të INSTAT mbi buxhetin e familjeve, familjet shqiptare për vitin 2024, shpenzuan mesatarisht **93 mijë lekë në muaj për konsum**, një rritje modeste prej 1,5% krahasuar me vitin 2023.

Tregu i Punës dhe Emigracioni

Në tremujorin e parë të 2025, punësimi u tkurr me **0.8%**, ndërsa bujqësia humbi **9.3% të vendeve të punës**. Sektori i shërbimeve është i vetmi që rritet, por jo në punë të qëndrueshme, kryesisht në turizëm (sezonal) dhe administratë. Në të njëjtën kohë, numri i pensionistëve që janë rikthyer në punë ka arritur në **120,000 persona mbi 65 vjeç** (rritje 46% nga 2023), një fenomen që dëshmon për **mungesë burimesh njerëzore dhe pamundësi për të mbijetuar me pensionin**.

Në anën tjetër, emigracioni mbetet problem fatal. Në dhjetë vjet, sipas EUROSTAT janë larguar **1.1 milionë shqiptarë**. Kjo tkurrje e fuqisë punëtore ul më tej prodhimin, dobëson sistemin e pensioneve dhe e bën ekonominë më të brishtë ndaj krizave. Qeveria e ka pranuar indirekt këtë, duke propozuar **importimin e punëtorëve aziatikë dhe afrikanë**, një zgjidhje e përkohshme, por në thelb **antikombëtare**, që zëvendëson shqiptarët e ikur pa i mbajtur ata që duan të rrinë.

Paraja e Pista dhe Ekonomia Informale

Problemi themelor nuk është mungesa e parasë, por burimi i saj. Paraja e pistë, e gjeneruar nga trafiku dhe pastrimi përmes ndërtimit, përbën tashmë një motor artificial të rritjes. Pesha e ndërtimit dhe aktivitetit të pasurive të patundshme në ekonomi ka arritur në 15% të PBB-së, sipas INSTAT. Gauetarja Ola Xama, në një analizë ekonomike tregonte se bankat financojnë rreth 22% të ndërtimit dhe blerjes së pasurive të patundshme. Nuk ka asnjë shpjegim nga autoritetet përgjegjëse se nga vjen pjesa tjetër e financimit.

Përgjatë këtij viti, media britanike City AM shkruante në një reportazh se *“Sigurisht, nuk ka shifra zyrtare, por vendi tani quhet "Kolumbia e Evropës". Vlerësimet sugjerojnë se midis një të tretës dhe gjysmës së produktit kombëtar bruto të Shqipërisë vjen nga trafiku i drogës. Sidoqoftë, disa miliardë euro gjenerohen nga trafiku i drogës çdo vit”*. Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit

për INCSR 2025 vlerëson se “korrupsioni, krimi i organizuar, boshllëqet në kuadrin ligjor dhe pengesat në komunikimin ndër-institucional e bëjnë Shqipërinë vulnerabël ndaj pastrimit të parave, ku kriminelët përdorin blerje pasurish të paluajtshme, projekte ndërtimi, asete virtuale dhe biznese të ndryshme për të pastruar paratë e pista”. Mediat raportojnë vazhdimisht për sasi të mëdha të kapura nga autoritetet e huaja, të cilat në total shkojnë minimalisht në 20% të PBB-së. Ky është një mekanizëm që deformon konkurrencën, zhvendos kapitalin nga prodhimi në betoniere, dhe rrit fiktivisht çmimet e pasurive, duke e bërë edhe strehimin të papërballueshëm.

Investimet e Huaja Direkte në pamje të parë janë rritur. Por, rritja nominale vjen nga riinvestimi i fitimeve ekzistuese, jo nga investitorë të rinj apo sektorë prodhues, si dhe nga blerjet në sektorin e pasurive të patundshme. Pra, Shqipëria po pasurohet mbi letër, por varfërohet në përmbajtje.

Borxhi Publik dhe Perceptimi Shoqëror

Borxhi publik, ndonëse zyrtarisht bie në 53.6% të PBB-së, perceptohet pozitivisht nga publiku vetëm sepse “nuk ndjehet”. Në realitet, kostoja e interesave është rritur në **36 miliardë lekë**, duke ngrënë hapësira që mund të përdreshin për investim produktiv. Në këtë kontekst, raporti i BE-së për Shqipërinë (nëntor 2025) e pranon “stabilitetin fiskal nominal”, por kërkon “reforma të thella në strukturën e taksave dhe rritjen e efikasitetit të shpenzimeve publike”. Nga ana tjetër, PPP-të janë një formë borxhi i fshehur, për të cilët edhe Departamenti i Shtetit në raportin e vitit 2025 të Klimës së Investimeve në Shqipëri, ngre shqetësime për transparencën dhe impaktin e tyre në ekonomi.

Nga viti 2017 në vitin 2024, buxheti i shtetit ka paguar dhe pritet të paguajë mbi 800 milionë euro (86 miliardë lekë) për 12 kontrata PPP. Nga këto, 6 prej tyre, me vlerë totale rreth 400 milionë euro (40 miliardë lekë) janë në SPAK. 25 miliardë janë vetëm kontratat për koncesionet në shëndetësi. Pagesat për kontratat koncesionare, disa prej të cilave janë debatuar si raste madhore korrupsioni, u financuan gjatë 9-mujorit 2025 me 9.61 miliardë lekë, (rreth 100 milionë euro) ose sa 69% e planit vjetor.

Sipas Ministrisë së Financave, muaji shtator ka shënuar nivelin më të lartë të pagesave me 2.14 miliardë lekë, ose 22.3% të totalit të nëntëmujorit, ku pjesën më të madhe e zë kontrata për “Rrugën e Arbrit” me rreth 1 miliard lekë, që përbën 47.1% të totalit të pagesave të atij muaji. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024, pagesat e nëntëmujorit 2025 janë rritur me 289.5 milionë lekë, ose 3.1% më shumë. Edhe buxheti për vitin 2026 vendos një fokus të madh te vazhdimi i PPP-ve, me 125 milionë euro nga fondet publike që parashikohen t’u dedikohen PPP-ve.

Gjithashtu shqetësuese është shifra e lartë që qeveria shqiptare ka detyrime për humbjet në arbitrazh. Deri në shtator 2025, Ministria e Financave llogarit një detyrim prej 180 milionë euro të lidhur me arbitrazhet ndërkombëtare.

Klima e Biznesit dhe Varfëria Strukturore

OECD, në raportin e konvergjencës së vendeve të Ballkanit Perëndimor me Bashkimin Europian, e rendit Shqipërinë në fund të rajonit për klimën e biznesit dhe infrastrukturën. Në raportin e fundit të Departamentit Amerikan të Shtetit për vitin 2025, Shqipëria përshkruhet si një vend me disa probleme në fushën e investimeve dhe sundimit të ligjit, të cilat ndikojnë në klimën e përgjithshme të biznesit.

Në dokument thuhet se sfidat kryesore që dëmtojnë ambientin e biznesit përfshijnë korrupsionin e përhapur, një sistem gjyqësor të dobët, mungesën e transparencës në prokurimet publike, si dhe praninë e madhe të ekonomisë informale dhe pastrimit të parave – sidomos me burim nga trafiku i drogës, siç e shpreh raporti i Departamentit të Shtetit për Klimën e Investimeve 2025, dhe media të ndryshme ndërkombëtare dhe kombëtare. Kontratat e partneritetit publik-privat (PPP) përmenden si një tjetër burim shqetësimi, pasi, sipas raportit, ato shpesh janë hartuar pa analizë të thelluar dhe me mungesë të ekspertizës profesionale. Kjo ka kufizuar pjesëmarrjen e investitorëve të huaj dhe ka krijuar terren për favorizime.

Pabarazitë rajonale thellohen: **58.2% e bizneseve** janë të përqendruara në Tiranë-Durrës, ndërsa **41% e popullsisë** jeton atje. Në zonat e tjera, mungojnë logjistika, rrugët dytësore, sistemet e vaditjes dhe kreditimi bujqësor.

41% e popullsisë është në kushte varfërie ose përjashtimi social, ndërsa varfëria ekstreme në nivel 20%, më të lartat në Europë. Varfëria është më e thellë në zonat rurale dhe në veriun e vendit, ku mungesa e investimeve publike është kronike.

Siguria në vend

Në vitet e fundit, veçanërisht përgjatë vitit 2025, nga raporte të organizatave, institucioneve e mediave ndërkombëtare dhe shqiptare, Shqipëria është identifikuar si e ekspozuar ndaj krimit të organizuar, sidomos në trafikimin e drogës dhe pastrimin e parave, me ndikime mbi ekonominë, median dhe proceset zgjedhore. Raporti INCSR 2025 i Departamentit të Shtetit evidenton se korrupsioni, krimi i organizuar, boshllëqet në kuadrin ligjor dhe pengesat në komunikimin ndër-institucional e bëjnë Shqipërinë vulnerabël ndaj pastrimit të parave, ku kriminelët përdorin blerje pasurish të paluajtshme, projekte ndërtimi, asete virtuale dhe biznese të ndryshme për të pastruar paratë e pista. Sipas raportit, organizatat kriminale shqiptare bashkëpunojnë me organizata të ngjashme në Europë dhe Amerikën e Jugut, dhe trafikimi i narkotikëve dhe krimi i organizuar janë një burim kryesor i flukseve të pastruara të parave. Po aty theksohet se ligjërimi i basteve online (mars 2024) *“ngre shqetësime se mbikëqyrja e dobët mund të lejojë depërtimin e krimit të organizuar”*.

Sipas po këtij raporti të Departamentit të Shtetit, pjesa më e madhe e pastrimit të parave në Shqipëri lidhet me trafikimin e drogës dhe qenieve njerëzore, mashtrimin me kontrata qeveritare, evazionin

fiskal dhe kontrabandën. Ekonomia e Shqipërisë, e bazuar kryesisht në para *cash*, me një nivel të lartë i formal, të llogaritur në 30% të PBB-së, me kontrolle të dobëta kufitare dhe zbatimimi të dobët të doganave lehtëson tregun e zi për mallrat e kontrabanduara. Remitancat dhe investimet nga jashtë herë pas here errësojnë burimet e fondeve. Kriminelët pastrojnë të ardhurat përmes blerjeve të pasurive të paluajtshme, projekteve të ndërtimit, aseteve virtuale dhe zhvillimit të biznesit.

Ndërkohë, përtej krimit të organizuar dhe karteleve, jeta në Shqipëri është më pak e sigurt, me raportime të përditshme të vrasjeve, aksidenteve, e mandej situatës së zjarreve që kalon vendi çdo vit, apo përmbytjeve.

Indeksi Global i Krimit të Organizuar 2025, publikuar në nëntor 2025 tregon që Shqipëria ka nivelin më të lartë të kriminalitetit në rajon, dhe ka grupet mafioze me ndikim të konsiderueshëm në ekonomi.

Për 2026-ën, funksioni “Rendi dhe Siguria Publike” që mund të preket nga ministri të tjera përveç asaj të brendshme, arrin 55.9 miliardë lekë, ose 2.01% të PBB-së, ndërsa Ministria e Punëve të Brendshme do të ketë 35.7 miliardë lekë, 1.3% e PBB. Në pamje të parë, kjo duket si rritje, por struktura e shpenzimeve tregon të kundërtën: pjesa dërrmuese shkon për paga dhe mirëmbajtje (gati 60%), apo projekte aktuale, ndërsa investimet në logjistikë, teknologji dhe hetim modern mbeten minimale.

Ndërkohë, Mbrojtja si funksion qeverisës: $43.0 / 886.8 \approx 4.9\%$ e shpenzimeve buxhetore → rreth 1.55% e PBB-së. Ministria e Mbrojtjes si institucion: $58.9 / 886.8 \approx 6.6\%$ e shpenzimeve buxhetore → rreth 2.1% e PBB-së. Qeveria luan me metodologjinë për të dalë mirë në fasadë, ndërsa kapacitetet reale luftarake mbeten të ulëta. Nga ana tjetër, kompania KAYO e krijuar nga qeveria për të riformuar industrinë mbrojtëse, nuk gjendet kund të buxhet.

Modeli i PPP-ve dhe aferave të inceneratorëve, portit të Durrësit dhe aeroportit të Vlorës po kopjohet edhe tek mbrojtja, dhe kjo është tejet shqetësuese për sigurinë tonë kombëtare.

Gjithashtu, kemi sigurinë ushqimore që është përtokë, me raste të shumta të frutave me pesticide, apo ushqimeve me salmonelë, për të cilat qytetarët i marrin vesh kur ndalohen nga shtetet e tjera. Pra, nuk kemi as laboratorë, as mundësi për të evidentuar këto raste dhe as kontroll të mëtijshëm se çfarë ndodh me produktet e kthyera në kufi. Siguria ushqimore në këtë buxhet është 0.1% e PBB-së, shifra më e ulët në Europë.

Shëndetësia

Shpenzimet për kujdesin shëndetësor në Shqipëri janë në nivele skandaloze. Me vetëm 464.7 dollarë amerikanë për frymë, shpenzimet për shëndetësi në Shqipëri janë rreth dy herë më të ulëta se në Serbi dhe Malin e Zi, dhe plot shtatë herë më të ulëta se në Itali. Diferenca bëhet edhe më

dramatike kur krahasojmë shpenzimet me Gjermaninë, ku ato për frymë janë 14 herë më të larta se në Shqipëri. Ky nivel i ulët investimi ka implikime të thella për cilësinë dhe aksesin në kujdesin shëndetësor për qytetarët shqiptarë.

Edhe kur analizojmë përqindjen e PBB-së që shpenzohet për shëndetësinë, Shqipëria mbetet pas vendeve të tjera. Me vetëm 7.3% të PBB-së të dedikuar për shëndetësinë, Shqipëria është pas Malit të Zi (10.6%), Serbisë (10.0%), Italisë (9.0%) dhe sidomos Gjermanisë (12.7%). Kjo tregon se edhe pse ekonomia shqiptare është më e varfër krahasuar me këto vende, edhe përqindja e burimeve që i dedikohet shëndetësisë është më e ulët. Kjo e bën të pamundur përmirësimin e shërbimeve shëndetësore dhe të infrastrukturës së nevojshme për kujdesin ndaj pacientëve.

Problemi më i madh për Shqipërinë është se pjesa më e madhe e shpenzimeve për shëndetësinë vijnë nga xhepi i qytetarëve, me një përqindje të lartë prej 59.7%. Në Gjermani dhe Itali shpenzimet private janë shumë më të ulëta, përkatësisht 12.2% dhe 21.9%. Kjo reflekton një sistem shëndetësor publik të fuqishëm që kujdeset realisht për shëndetin dhe mirëqenien e qytetarit.

Varësia e kujdesit shëndetësor shqiptar nga shpenzimet private sjell një sërë problemesh, si rreziku për shpenzime katastrofike që mund të çojnë në varfëri, qasje të kufizuar në kujdesin shëndetësor për grupet e popullsisë me të ardhura të ulëta, dhe një pabarazi të thelluar në shëndet. Gjithashtu, rritja e shpenzimeve private krijon një presion të madh mbi familjet dhe minon kohezionin social, duke rritur pabarazinë në shëndetësi.

Nuk ka tregues më domethënës për shëndetin se sa numri i foshnjave me moshë 0-1 vjeç që humbin jetën për çdo 1,000 foshnja të lindura gjallë. Vdekshmëria foshnjore në Shqipëri është 8.4 për 1,000 lindje të gjalla, një shifër dukshëm më e lartë se në vendet e tjera të marra në shqyrtim. Për shembull, në Itali dhe Malin e Zi, kjo shifër është përkatësisht 2.2 dhe 2.3 për 1,000 lindje të gjalla. Kjo tregon se keqfinancimi dhe keqqeverisja e sistemit shëndetësor në Shqipëri kanë pasoja të drejtpërdrejta dhe të rënda, si për sasinë ashtu dhe për cilësinë e kujdesit shëndetësor, veçanërisht për foshnjat dhe nënat.

Nivelet skandaloze të vdekshmërisë foshnjore janë një tregues i qartë i mungesës totale të vëmendjes së qeverisë për shëndetin dhe jetën e qytetarëve shqiptarë. Shteti që nuk kujdeset as për shëndetin dhe jetën e foshnjave nuk mund të kujdeset për asnjë prej kategorive të tjera të të sëmurëve.

Duke analizuar te tjera burime statistikore dhe analiza te kryera ne vazhdimësi, por me pasoja të rëndësishme për shëndetin e popullatës:

- a. Shqiptaret sot jetojnë 7 vite me pak se qytetarët e BE;
- b. Ne Shqipëri, nga 1000 foshnja te lindura gjalle, vdesin brenda vitit te pare te jetës 3.4 here me shume se ne BE;
- c. Shqiptaret kane sot rreth 2.5 here me pak mjeke e infermiere se qytetarët e BE;
- d. Shqiptaret vdesin 1.8 here me shume nga sëmundjet kardiovaskulare se qytetarët e BE;

- e. Shqiptaret kane sot rreth 2 here me pak spitale dhe shtretër spitalore,
- f. Shqiptaret paguajnë nga xhepat e tyre sot 60% te shpenzimeve për shëndetin e tyre krahasuar me 25% qe paguajnë qytetaret e BE;
- g. Megjithëse Shqipëria shpenzon pothuajse sa mesatarja e vendeve te rajonit, treguesit kryesore te cilësisë dhe efikasitetit të sistemit shëndetësore janë skandaloze.

Ndërkohë, ne kemi probleme me barnat, të cilat shpesh raportohen si të skaduara ose me cilësi të keqe, me mjekët të cilët janë larguar në numër të madh, dhe me koncesionet të cilat janë përpara drejtësisë. Skandali i Onkologjikut mbetet një nga shembujt më flagrantë të situatës së shëndetësisë në vend.

Arsimi

Rezultatet e PISA 2022 treguan qartë situatën në Arsim: performanca mesatare e 15-vjeçarëve shqiptarë ra në **matematikë, lexim dhe shkencë** krahasuar me 2018-ën. Ky nuk është vetëm një devijim statistikor; është një kthesë e qartë negative në trendin e mëparshëm.

Por PISA është vetëm maja e ajsbergut. Në terren, **rrjedhja e mësuesve**, klasat e kombinuara në zona të thella, dhe ulja e pjesëmarrjes në gjimnaz për shkak të shpopullimit përbëjnë një “alarm të heshtëm”: më pak nxënës, më pak mësues të mirë, më shumë hendek mes qytetit dhe fshatit. Shpopullimi, sidomos në zonat rurale, është një plagë që jo vetëm nuk adresohet, por as nuk njihet si problem nga Qeveria.

Kërkimi shkencor: motor i fikur

Në të njëjtën kohë, motori që duhej të tërhiqte cilësinë e universiteteve, **kërkimi shkencor**, punon me rrymë të ulët. Shpenzimet për K&Zh mbeten në fund të Europës; Komisioni European ka vënë në dukje se edhe në 2023 arritëm rreth **0.08% e PBB-së**, larg objektivit minimal **1%** deri në 2030. Edhe analizat për vitin 2025 për ekosistemin e inovacionit e përforcon të njëjtën tezë: pa financim që të paktën prek **1% të PBB-së** dhe pa lidhje universite-industri, sistemi nuk gjeneron dije të eksportueshme. Indikatorët e ekonomisë së dijes në paketën e Zgjerimit 2024 e rikonfirmuan hendekun tonë strukturor në kërkim, inovacion dhe transferim teknologjie.

Ky boshllëk i kërkimit përkthehet në **rankime të zbehta ndërkombëtare** dhe në universitete që diplomojnë më shumë sesa prodhojnë dije, një problem që e sheh edhe opinionimi publik kur vëren se rangimet globale rrallë na shfaqin si qendra ekselence kërkimore.

Ky është realiteti që buxheti 2026 trashëgon: një ekonomi që **ngjan e qëndrueshme në pamje të parë të shifrave**, por që **rrënohet në strukturë**. Një model që e ka zëvendësuar **prodhimin me**

ndërtimin, përparimin me iluzione statistikore, dhe punën me transfera sociale. Dhe një situatë sociale, kulturore arsimore e shëndetësore, tejet problematike.

Në këtë kontekst, çdo buxhet që nuk ndryshon filozofinë, nga **konsum në prodhim**, nga **shtet në treg**, nga **afatshkurtër në strategjik**, nuk është reformë, por thellim i krizës.

Projektbuxheti i prezantuar nga Qeveria

Korniza makro-fiskale: Rritje në Letër, Brishtësi në Thelb

Buxheti 2026 parashikon **të ardhura 823 mld lekë, shpenzime 886.8 mld lekë dhe deficit 63.7 mld lekë** (rreth 2.3% e PBB-së). Krahasuar me 2025 (pas AN nr.10: 770 mld të ardhura, 831.8 mld shpenzime, 61.6 mld deficit), kemi +6.9% të ardhura dhe +6.6% shpenzime. Në terma nominalë kjo duket e balancuar; në terma realë kjo është rritje që nuk përkthehet në mirëqenie: borxhi nuk ulet nga rritja e produktivitetit, por thjesht përthithet nga nominaliteti i PBB-së, si dhe forcimi artificial i lekut.

Qeveria parashikon borxh publik 53.6% e PBB-së në 2026. Por kjo ulje është iluzore nëse ekonomia nuk prodhon më shumë mallra e shërbime: profili i borxhit po rëndohet nga huamarrja e brendshme afatshkurtër dhe nga fatura e interesave (që i afrohet 64 mld lekëve), duke ngrënë hapësirën për investime me produktivitet. Edhe FMN uli projeksionin e rritjes 2025 në 3.4% (nga 3.8%), prandaj supozimi 4% real për 2026 është tejet optimist: mjafton -0.5 pp nën plan që të hapet vrimë të ardhurash nga TVSH dhe të priset ekuilibri i deficitit. Nën këto kushte, rritja e çmimeve bazë e ka bërë rritjen jo përfituese për familjet në nevojë: fuqia blerëse ka rënë, ndërkohë që kostoja e jetesës është rritur.

Nga ana tjetër, duhet pasur parasysh që edhe PPP-të dhe pagesat në arbitrazh janë një formë borxhi që duhet konsideruar.

Konkluzion: kemi stabilitet nominal, por brishtësi reale. Ekonomia mbahet nga shteti dhe paratë e pista, jo nga prodhimi e investimi.

Struktura e Buxhetit: Një Shtet që Rritet më Shpejt se Ekonomia

Narrativa e buxhetit më të madh në histori është një tullumbace: të ardhurat janë rreth 27–28% e PBB-së, shpenzimet 30–31%, pra në të njëjtin nivel me 30 vitet e fundit. Me taksa të dyfishuara e trefishuara, qeveria mbledh po aq sa në kohën e taksës së sheshtë.

Buxheti qendror zë pjesën dërrmuese të rritjes (581 mld të ardhura; 644.8 mld shpenzime). Buxheti vendor shkon në 97.8 mld (nga 89.9 mld në 2025), me grant nga qendra 47.3 mld (prej të cilave 4.5 mld kompensim për efektin e pagave). Grantet e performancës janë simbolike (200 mln lekë),

kriteret e përdorimit i përcaktojnë qendra dhe FSHZH, ndërsa bashkitë mbeten thjesht ekzekutorë. Portofoli i shpenzimeve tregon shtim të aparatit burokratik (paga/kontrata).

Në të ardhura, rritja bazohet në rritjen e pagave si pasojë e ndërhyrjes qeveritare, rritjes së çmimeve dhe për rrjedhojë arkëtimit të TVSH (edhe kjo si pasojë e rritje së çmimeve), dhe jo si pasojë e prodhimit apo rritjes organike të ekonomisë. Ky është thelbi i problemit: kur rritja qëndron mbi faturën (konsum), jo mbi fabrikën (prodhim), modeli është konsum-mbajtës, jo ofertë-rritës. **TVSH mbetet kontribuuesi kryesor, me 8.4% të PBB-së, ndërsa TAP rreth 3.6% e PBB.** Sistemi fiskal vazhdon ende mbetet kryesisht në varësinë e konsumit të brendshëm.

Vendosja e 2026 në kornizë 3-vjeçare: MF projektton rritje mesatare ~4%/vit, deficit 2.3% PBB dhe borxh 53.6% në fund 2026. Objektivi i uljes së borxhit 2027–2028 mbështetet më shumë te nominaliteti dhe kursi, sesa te zgjerimi i bazës prodhuese.

Presioni pas 2026 (PIP): Lista e projekteve të investimeve publike 2026–2028 është e gjerë; profilimi i pagesave shtyn presionin kapital në vitet e ardhshme, me rrezik mosrealizimi ose shtyrje detyrimesh.

Shpenzimet publike shkojnë nga 28.9% e PBB në 2024, në 31.9% në vitin 2026, me programe sociale dhe investimet aktuale publike. **Shpenzimet kapitale kanë rritje nominale, por rënie reale për shkak të inflacionit ndërtimor.** Pagat (konsum publik) kanë rritje për shkak të indeksimit dhe rritjes së stafit publik. Shpenzimet sociale në rritje graduale. Problematik është fakti që shlyerja e shumë detyrimeve lihet për në muajt e fundit të vitit, duke lënë një suficit primar në pjesën më të madhe të vitit fiskal, dhe duke shtyrë detyrime edhe për vitet në vijim. Detyrimet e prapambetura të qeverisë qendrore kanë shënuar një rritje të ndjeshme në fund të tremujorit të tretë të vitit 2025, pavarësisht faktit që buxheti i shtetit ka rezultuar me suficit për shkak të mosrealizimit të investimeve publike, që tregon keqmenaxhim të financave publike.

Nga ana tjetër, numri i të punësuarve në sektorin publik (qendror, lokal, institucione të pavarura, ndërmarrje publike) është rritur me mijëra, kryesisht të punësuar partiakë (apo të njohur rëndom si patronazhistët), duke e kthyer administratën në instrument elektoral. Tremujori I 2025: numri i të punësuarve në administratën publike arriti në 185,387 persona, një rritje me +1,109 punësime vetëm në tre muajt e parë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024, administrata u zgjerua me +3,630 persona. Tremujori II 2025: numri i të punësuarve në sektorin publik arriti në 185,734–186,000 persona, niveli më i lartë i shënuar në mbi dy dekada.

Nëse krahasojmë me vitin 2019 (172,900 të punësuar), administrata publike është rritur me **+12,500 persona** deri në 2025, ndërkohë që popullsia e vendit është tkurrur me mbi 500 mijë banorë. Raport punësimi/popullsi: në 2002 kishim 1 të punësuar në shtet për çdo 16 banorë; sot kemi **1 të punësuar në shtet për çdo 12 banorë. Fatura e pagave të sektorit publik është rritur**

me 20% në gjashtëmujorin e parë 2025, ndërkohë që të ardhurat buxhetore u rritën vetëm me 6.7%.

Ndërkohë, vërtet borxhi duket në ulje, por duhet pasur parasysh që kemi një zhvlerësim drastik të euros dhe dollarit. Nëse do të përdornim kursin e këmbimit të vitit 2013, borxhi do të shkonte në mbi 70% të PBB. Pra, borxhi publik ka rënë vetëm për shkak të uljes së peshës së borxhit të jashtëm, si rezultat i kursit euro/lek. Nuk është meritë e politikave fiskale, por efekt i kursit të këmbimit.

Skenari i mundshëm i rritjes më të ulët (2026)

Ky është një nga **sensitivitetet fiskale më të rëndësishme** për buxhetin 2026. Nëse rritja reale bie nga **4% e planifikuar** në **3.3%** (pra -0.7 pp), në një nivel të ngjashëm me realizimin e vitit 2025, efekti është i menjëhershëm në të ardhurat dhe deficitin.

1. Efekti mbi të ardhurat

- **TVSH:** si taksa kryesore (8.4% e PBB-së), është e lidhur ngushtë me konsumin. Një ngadalësim i rritjes reale ul bazën e konsumit të tatueshëm.
 - Elasticiteti i TVSH ndaj rritjes është rreth 1.2–1.5. Pra, -0.7 pp rritje → -1.0% deri -1.5% të ardhura nga TVSH.
 - Kjo përket në **-5 deri -7 mld lekë** më pak të ardhura.
- **Tatimi mbi fitimin:** sektori prodhues është tashmë negativ (-2.5% bujqësi, -1.8% industri në 2025). Një ngadalësim shtesë ul fitimet e tatueshme.
 - Efekt i mundshëm: **-2 deri -3 mld lekë** më pak.
- **Akcizat dhe TAP:** ndikimi është më i vogël, por gjithsesi -1 deri -2 mld lekë.

Totali: -8 deri -12 mld lekë më pak të ardhura në vitin 2026.

2. Efekti mbi deficitin

- Deficiti i planifikuar: **63.7 mld lekë (2.3% PBB)**.
- Me -8 deri -12 mld lekë të ardhura më pak, deficiti shkon në **71–75 mld lekë**.
- Kjo e çon raportin deficit/PBB në **2.5–2.7%**, duke thyer objektivin e stabilitetit nominal.

3. Efekti mbi borxhin

- Borxhi publik i planifikuar: **53.6% PBB (1,445 mld lekë)**.
- Me deficit më të lartë, borxhi nuk bie sipas planit, por mbetet mbi **54% PBB**.
- Nëse kursi i këmbimit EUR/LEK normalizohet (pra lek dobësohet), borxhi i jashtëm rrit peshën dhe mund të shkojë në **56–57% PBB**.

4. Pasoja politike dhe fiskale

- **Narrativa e stabilitetit fiskal** rrëzohet: qeveria nuk arrin të mbajë deficitin nën 2.3% PBB.
- **Shpenzimet sociale dhe pagat publike** janë të vështira për t'u shkurtuar, prandaj presioni bie mbi investimet publike (180 mld lekë plan).
- **PPP dhe arbitrazhet** shtojnë riskun: nëse materializohen pagesa shtesë, deficiti mund të kalojë edhe **2.8% PBB**.

Shpenzimet Korrente: Konsum Publik në Vend të Prodhimit

Në 2026, **shpenzimet për paga dhe kontribute** arrijnë në rreth **140 miliardë lekë**, me efektin e rritjes së pagës minimale në **50,000 lekë** dhe indeksimin 2.5%. Por nuk mund të rritet paga minimale në mënyrë arbitrare pa u rritur prodhimi që të justifikojë këtë rritje page, sepse kthehet në barrë për sektorin privat. Kjo masë duhej shoqëruar me politika që inkurajojnë prodhimin, konkurrencën, inovacionin.

Në anën sociale, **bonusi për pensionistët** arrin **10 miliardë lekë**, nga 9.7 miliardë një vit më parë, ndërsa **transferet nga buxheti për sigurimet shoqërore** janë **28.6 miliardë lekë**, nga 35.8 miliardë në 2025.

Rritja e kontributeve nuk reflekton rritje të punësimit real, por thjesht efekt nominal nga paga minimale më e lartë.

Në fakt, skema e sigurimeve mbetet **strukturalisht e pabalancuar**, me rënie të numrit të kontribuuesve për shkak të emigracionit dhe plakjes së popullsisë.

Ky është buxhet që shpërndan në PPP apo projekte jo produktive, por **nuk prodhon** asgjë më shumë. Një politikë fiskale zhvilluese do të kërkonte ulje të barrës tatimore e burokratike mbi punën dhe biznesin, jo zgjerim të shpenzimeve sociale pa mbulesë ekonomike.

Investimet Publike: Shifra të Mëdha, Produktivitet i Vogël

Investimet publike për 2026 parashikohen **180 miliardë lekë**, ose **6.5% të PBB-së**, nga 164 miliardë në 2025, me fokus në **projekte infrastrukturore dhe urbane**, jo drejt prodhimit. Nuk ka asnjë vepër madhore që të mund të mbahet mend, nga një shifër e tillë e investimeve, përgjatë dekadës së fundit.

Pjesa më e madhe e fondeve kalon përmes FSHZH, i cili **jo vetëm që programon, por edhe zbaton vetë projektet**, ndërsa rregullat e përzgjedhjes dhe monitorimit miratohen nga vetë Këshilli i tij Drejtues.

Ky është një **konflikt interesash institucional** dhe një **sistem pa filtra të vlerës për para (VFM)** apo të analizës kosto-përfitim (CBA). Në praktikë, fondet qarkullojnë brenda një rrethi të mbyllur, ku politika zgjedh projektet, burokracia i miraton, dhe FSHZH i zbaton.

Për vitin 2026 parashikohen 5 miliardë lekë për procesin e rindërtimit që prek me mijëra familje të dëmtuara. Qeveria një vit më parë u shpreh se nuk do të kishte nevojë për financim përtej financimit 2025. Nuk dihet se nga doli kjo nevojë shtese prej 5 miliardë lekësh.

Në **listën e Projekteve të Investimeve Publike (PIP) 2026-2028**, pjesa më e madhe e fondeve shkon për rrugë, transformim urban, qendra multifunksionale dhe projekte turistike, ndërkohë që nuk është ky prioriteti, apo ajo çka ka nevojë ekonomia shqiptare. Gjithashtu, media ka raportuar vazhdimisht për kostot e larta të rrugëve apo projekteve infrastrukturore, shumë më të larta se në

Europë, dhe skandalet me PPP apo tenderat publikë, shqetësime të ngritura dhe nga raporti i Klimës së Investimeve të Departamentit Amerikan të Shtetit.

Në anën tjetër, **bujqësia, energjia, industria dhe infrastruktura logjistike**, shtyllat e çdo ekonomie prodhuese, marrin pjesën më të vogël.

PPP-të dhe Koncesionet: Borxh i Padukshëm dhe Investime që Nuk Krijojnë Ofertë

Në dokumentet shoqëruese të projektbuxhetit, veçanërisht në “Listën e Koncesioneve dhe PPP-ve”, tregohen dhjetëra kontrata aktive në infrastrukturë, shëndetësi dhe energji, pa transparencë të plotë për kostot neto dhe riskun fiskal.

Asnjë tabelë nuk jep ndikimin e tyre në deficitin e përgjithshëm, as analiza të vlerës për para. Media të ndryshme dhe ekspertët kanë theksuar se një pjesë e madhe e këtyre projekteve “nuk sjellin vlerë të shtuar produktive, por ngarkojnë borxhin publik në mënyrë të fshehtë”, duke krijuar “fitim të garantuar privat mbi rrezik publik”.

Raporti i **Transparency International** për Shqipërinë, si dhe raportet e **Departamentit Amerikan të Shtetit**, kanë paralajmëruar për mungesë konkurrimi real në tenderat PPP dhe lidhje me pastrimin e parave.

Në një ekonomi ku krimi i organizuar ka depërtuar në sektorë si ndërtimi dhe energjia, mungesa e analizave ekonomike të pavarura e kthen PPP-në në **instrument politik dhe financiar të klientelizmit**.

Nga pikëpamja jonë, **PPP-të duhen vetëm nëse krijojnë ofertë të re dhe produktivitet**, siç janë termocentralet, hekurudhat apo portet eksportuese, jo për projekte kozmetike urbane që rrisin shpenzimin, por jo prodhimin.

Në të kundërt, PPP-të bëhen **forma moderne e borxhit të padukshëm**, që deformon konkurrencën dhe zhduk transparencën publike.

Arsimi dhe Shëndetësia: Rënia e Investimit në Kapitalin Njerëzor

Ndërsa buxheti total rritet, pesha e **arsimit dhe shëndetësisë** në totalin e shpenzimeve vazhdon të ulet.

Sipas të dhënave dhe vlerësimeve të mediave kritike, **arsimi merr më pak se 7.3% të buxhetit**, në rënie nga 8.2% në vitin e kaluar, dhe **rreth 2.5% e PBB-së**, ndërsa shëndetësia mbetet në nivele të ngjashme me vitin e kaluar, **në 2.9% të PBB**.

Në arsim, rritja e pagave për mësuesit dhe investimet në infrastrukturë nuk shoqërohen me reforma të cilësisë, nuk ka programe për trajnimin e mësuesve, digjitalizimin e shkollave, kërkimin shkencor, mbajtjen e mësuesve sidomos në zonat rurale, frenimin e shpopullimit që po çon në

mbyllje masive të shkollave e programeve studimore, klasat mbeten me dy turne, siguria në shkolla mungon, kurikulat sipas ekspertëve lënë për të dëshiruar, apo integrimin e arsimit profesional me tregun e punës.

Buxheti i vitit 2026 nuk sjell asnjë risi për arsimin. Ai mbetet i orientuar tek detyrimet afatgjata për koncesionet dhe kostot e larta të infrastrukturës, duke lënë pas dore investimin në dijen, fëmijët dhe të rinjtë. Me vetëm **2.53% të PBB-së** të dedikuar për arsimin dhe shkencën, Shqipëria renditet në nivelin e vendeve të botës së tretë. Arsimi parashkollor dhe 9-vjeçar marrin 1.33% të PBB-së, arsimi i mesëm 0.61%, arsimi i lartë vetëm 0.46% (madje me ulje krahasuar me 2025), ndërsa kërkimi shkencor mbetet në nivelin skandaloz **0.06% të PBB-së**. Objektivat e qeverisë deri në 2028 parashikojnë që vetëm 84% e nxënësve të regjistrohen në arsimin e mesëm, duke lënë jashtë sistemit 16% të rinjve, një politikë e papranueshme për një vend që synon integrimin Europian. Financimi për çdo nxënës dhe student është të paktën 10 herë më i ulët se mesatarja e BE/OECD, duke prodhuar një sistem arsimor të dobët, pa kushte, pa kërkim shkencor dhe pa perspektivë. Ky nivel investimi e bën të pamundur ndalimin e emigrimit masiv të rinisë dhe e kthen arsimin në një sektor thjesht mbijetese, jo zhvillimi.

Me një PBB 28,3 miliard Euro dhe buxhet prej gati 9 miliard Euro, nuk mund të ulet buxheti për arsimin e lartë dhe të planifikohet nga qeveria vetëm përafërsisht 1250 Euro / student (110 milion Euro jep qeveria, sepse pjesa tjetër, afërsisht 20-25 milion Euro janë nga tarifat e studenteve). Me këtë nivel buxheti prej 9 miliard Euro, duhet të ishte buxheti i AL të paktën 150 milion Euro, të përgjysmoheshin tarifat e Masterit, të rriteshin të paktën 15% pagat e pedagogëve, dhe të ndryshonin krejtësisht kushtet në godinat universitare.

Në shëndetësi problemi mbetet cilësor: mungesa e mjekëve, ikja e stafit drejt vendeve të BE-së dhe rënia e besimit në sistem nuk adresohen. Kemi koncesione të cilat janë përpara drejtësisë, kemi skandalin në onkologjik, barna të skaduara, apo të munguara, e të tjerë probleme të renditura në krye të kësaj analize, që ky buxhet nuk i adreson. Asnjë masë e re nuk parashikohet për partneritete reale me sektorin privat, për modele bashkëpagesash apo për përmirësim të logjistikës mjekësore.

Ky është një sinjal i qartë: **qeveria po braktis investimin në kapitalin njerëzor**. Në një vend që po zbrazet nga të rinjtë, **arsimi dhe shëndetësia nuk janë shpenzim, por investim për mbijetesë kombëtare**.

Një qasje e duhur do të duhej të investonte pikërisht këtu, për të ndalur emigracionin, për të rritur produktivitetin dhe për të rigjallëruar klasën e mesme.

Fonde Speciale dhe Skemat e Varura nga Buxheti

Fondi i Sigurimeve Shoqërore parashikon të ardhura dhe shpenzime 195.3 miliardë lekë, me kontribute 166.7 miliardë dhe transfertë nga buxheti 28.6 miliardë.

Ndërkohë, baza kontribuuese vazhdon të tkurret, ndërsa deficit i degës së pensioneve mbulohet nga rezerva. Pa reformë aktuariale dhe pa rritje të punësimit formal, e sidomos pa zhbërje të shpopullimit kjo skemë mbetet **e paqëndrueshme në afatmesëm**.

Ndryshe nga çdo duhet të pritej nga një qeveri e majtë, ndihma ekonomike për familjet në nevojë është në nivelin e turpshëm 14–15 euro/muaj për anëtar, duke treguar mungesë totale të politikave sociale.

Ndërkohë, pensionet rriten në mënyrë minimale, shumë më pak se rritja e çmimeve. Bonusi i pensionistëve është rreth 100 milionë euro, tërësisht i papërfillshëm.

Sigurimet shëndetësore dhe shoqërore vazhdojnë të rriten për shkak të rritjes së pagës minimale, indeksimit të pagave publike dhe rritjes së punësimit formal, të cilat janë kosto për sektorin privat, pa asnjë lehtësi për ta. Pasoja do jetë ngadalësim në punësimin në sektorë me norma të ulëta fitimi, shërbime e tregti.

Red Flags: Sinjalet e Rrezikut Fiskal dhe Struktural

1. **Centralizim:** FSHZH, qeveria qendrore dhe Kryeministria kontrollojnë çdo instrument financiar dhe personel administrativ.
2. **PPP pa transparencë:** Fokus në PPP dhe investime publike, por pa transparencë, me kosto shpesh të fryra në të kaluarën, dhe jo prioritare kur kemi të bëjmë me një situatë krize në sektorët prodhues. Nga ana tjetër, janë borxh i padukshëm, gjysma janë përpara drejtësisë, rrezik i lartë fiskal dhe mungesë e vlerës për para.
3. **Rënie e investimit në kapitalin njerëzor:** arsimi dhe shëndetësia vazhdojnë marrin përqindje të ulët të buxhetit dhe asnjë reformë strukturore për të adresuar problemet në këto sektorë.
4. **Strukturë pro-konsum, jo pro-ofertë:** rritje pagash, bonuse dhe transferta sociale pa efekte në produktivitet. Pagat rriten në mënyrë të qëndrueshme vetëm duke rrit prodhimin, inovacionin e konkurrencën, jo me dekret, siç ndodh me këtë buxhet. Çdo të ndodhë kur sektori privat të ndalojë së financuari programet qeveritare?
5. **Borxhi ulet si pasojë e kursit të këmbimit** dhe jo si pasojë e ndonjë reforme strukturore.
6. **Pushtet vendor i kontrolluar:** grantet rriten nominalisht, por përdorimi mbetet i kushtëzuar nga qeveria qendrore.

Përfundim: Një Mundësi e Humbur për Reformë të Vërtetë

Buxheti 2026 është buxhet i administratës, i klientelizmit, i centralizimit, i programeve joproduktive, dhe jo i shtetit që incentivon prodhimin e forcon sovranitetin ekonomik. Ai ruan rutinën e pagave/bonuseve dhe shtyn projekte me efekt të ulët shumëzues në ekonomi, por nuk krijon asnjë nga shtyllat që duhen: ofertë prodhuese, eksporte, kapital njerëzor dhe zinxhirë të ftohtë/logjistikë. Në vend që të ulim taksat mbi punën dhe prodhimin, të deregulojmë, të heqim

trysninë e shtetit e burokracisë mbi individin, familjet e sipërmarrjet, të rishikojmë PPP-të, të ulim shpenzimet e tepërta, dhe të rrisim peshën e arsimit/shëndetësisë si investim kundër shpopullimit, ne zmadhojmë një shtet që jep tendera me kosto tejet të larta, shpërndan sot dhe lë pa oksigjen të nesërmen. Nëse vazhdojmë kështu, 2026 do të jetë edhe një vit tejet i vështirë për familjet dhe horizont i sheshtë për prodhuesit, sidomos në momentin kur, për arsye të jashtme, flukset e parasë së jashtëligjshme të ndërpriten.

Ky është një buxhet që **shpërndan për konsum, por nuk ndërton për të ardhmen.**

Qasja jonë, si të djathtë, do të bënte të kundërtën:

- do të ulte taksat për prodhuesit: Ulje e barrës mbi punën dhe biznesin (financuar nga prerja e zërave jo-prioritarë dhe rritja e formalitetit).
- do të investonte në kapitalin njerëzor (arsim dhe shëndetësi),
- do të mbështeste bujqësinë dhe industrinë përpunuese,
- do të kufizonte PPP-të që nuk sjellin vlerë reale. Rishikim i PPP, duke lënë vetëm projekte që rrisin ofertën (energji, hekurudhë, porte eksportuese, agro-logjistikë).
- Rialokim kapitalesh në zinxhirin prodhues (agro-përpunim, “cold chain”, teknologji/automatizim).
- Rritje e peshës së arsimit/shëndetësisë si investim kundër shpopullimit.
- Disiplinë borxhi: profil maturimesh më i gjatë, interesa më të ulëta përmes besueshmërisë fiskale.

Vetëm kështu ekonomia shqiptare mund të çlirohet nga varësia ndaj ndërtimit, remitançave dhe parave të pista dhe të kthehet në një ekonomi që **prodhon, eksporton dhe krijon punë të qëndrueshme**. Në të kundërt, 2026 do të jetë thjesht **një vit tjetër i stagnimit të financuar me borxh dhe iluzione**.